



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2580, datë 22.06.2015**

**Për**

**“Dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a. për përdorimin e frekuencave në brezin 1950-1965 MHz çiftuar me 2140-2155 MHz dhe 1910-1915 MHz spektër i paçftuar”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 22.06.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albtelecom” sh.a. për përdorimin e frekuencave në brezin 1950-1965 MHz çiftuar me 2140-2155 MHz dhe 1910-1915 MHz spektër i paçftuar”**

**BAZA LIGJORE:**

1. Shkronjat a, b, c, të pikës 1 dhe pika 2 e nenit 75, “Ndryshimet në autorizimin individual”, si dhe pikat 9, 10 të nenit 62 “Administrimi i spektrit të frekuencave” të Ligjit Nr.9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, datë 19.05.2008, *i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9918, “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë, datë 19.5.2008”*”;
2. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;

3. VKM Nr. 468, datë 30.05.2013 “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e broadband-it”, i ndryshuar me VKM Nr. 300, date 08.04.2015.
4. Vendimi Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.
5. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
6. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (**Relacioni**);
- Projekt-aktin
- si dhe,  
duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

### **V Ë R E N s e:**

1. Sipërmarrësi “Albtelecom” sh.a. është pajisur me Autorizim Individual për përdorimim e brezit të frekuencave 1950-1965 çiftuar me 2140-2155 MHz dhe 1910-1915 spektër i paçiftuar, miratuar me VKD Nr. 2215, datë 17.12.2012, për ndërtimin e rrjetit dhe ofrimin e shërbimit të telefonisë së lëvizshme.
2. VKM Nr. 300, datë 08.04.2015, për “Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 468, datë 30.05.2013, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e Broadband-it””, me anë të së cilës:
  - Autorizohet heqja e kufizimeve teknologjike dhe ndryshimi i autorizimeve individuale përkatëse pa pagesë shtesë nga ana e mbajtësit të autorizimeve,
  - Të nxiten mbajtësit e autorizimeve, sipas një akti të nxjerrë nga AKEP-i, që të rritin mbulimin me shërbime *broadband* në zonat me densitet të ulet të popullsisë si dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit të ofruar
  - Kryerjen nga AKEP të procesit të riorganizimit të spektrit në këto breza. Riorganizimi i spektrit, përmes modifikimit të autorizimeve individuale përkatëse të dhëna në brezat 900/1800 MHz, 2100 MHz, do të kryhet pas dhënies në përdorim të spektrit të lirë të mbetur në këto breza, por jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i procesit të dhënies në përdorim të këtyre brezave.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gërma c e pikës 1 dhe pika 2 e nenit 75,

2. VKM Nr. 468, datë 30.05.2013 “Për miratimin e planit kombëtar për zhvillimin e broadband-it”, i ndryshuar me VKM Nr. 300, date 08.04.2015.
3. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
4. Rregullorja për Autorizimin Individual, miratuar me VKD Nr. 2395 datë. 15.12.2013.

#### **V E N D O S :**

1. Të miratojë ndryshimet e autorizimit individual ekzistuese miratuar me VKD Nr.2215, datë 17.12.2012.
2. Të miratojë Autorizimin Individual të ri për sipërmarrësin “Albtelecom” sh.a. sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Të miratojë heqjen e kufizimeve teknologjike për frekuencat e brezit 1950-1965 MHz çiftuar me 2140-2155 MHz dhe 1910-1915 MHz spektër i paçiftuar të dhëna me këtë autorizim.
4. E drejta e përdorimit të spektrit pa kufizim teknologjik dhe shfrytëzimi i spektrit sipas Aneksit nr.2, fillon nga data 01.09.2015.
5. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual ekzistues miratuar me VKD Nr.2215, datë 17.12.2012 për përdorimin e frekuencave në brezin 1950-1965 MHz çiftuar me 2140-2155 MHz dhe 1910-1915 MHz spektër i paçiftuar mbetet i pa ndryshuar.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

#### **ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Anila DENAJ** \_\_\_\_\_
3. **Ketrin TOPÇIU** \_\_\_\_\_
4. **Klarina ALLUSHI** \_\_\_\_\_